LIGJ
Nr. 160/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996, "KODI I PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja "d", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 49, "Dispozitë kalimtare", i ligjit nr. 122/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

"Çështjet civile që janë në gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykohen sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesë-padisë.

Çështjet ende të paekzekutuara nga përmbaruesit gjyqësorë, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ekzekutohen sipas këtij ligji.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.10.2013

Shpallur me dekretin nr. 8382, datë 8.11.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani